

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** gjykata e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje nga gjyqtarët Suzana Çerkini kryetare dhe Fatime Dermaku e Kujtim Krasniqi anëtar, me sekretaren juridike Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të të akuzuarit E.N nga Prishtina, për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 328 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.204-2/11 të datës 18.04.2011 pas shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun të mbajtur më datë 30.04.2018 me praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Gashi dhe të akuzuarit E.N të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari E.N,** i biri i G. dhe nënës Gj, e vajzërisë A. i lindur me ... në fshatin G, Komuna D. ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mekanik, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ...,

### Ë S H T Ë F A J T O R

**Sepse, deri** me datë 15.01.2011 ka mbajtur në pronësi psitoletën e markës TT, kalibër 7.62 pa numër serie, pa leje valide për mbajtjen e autorizuar të saj, të cilën e ka përdorë të njëjtën datë rreth orës 01:15 në kafiterinë “M” në fshatin Arllat Komuna Glogoc, ku pasi ka dalë jashtë atij lokali, pa ndonjë qëllim të caktuar, nga disponimi duke dëgjuar muzikë ka shtënë dy herë në ajër me, ndërkaq pistoleta së bashku me karikatorin më pas i është sekuestruar nga patrulla policore,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja, ne pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 328 par.1 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11,15,34,41,42,43,44 par.1,45,54,60,64,66 par.1 pika 2, 67 par.1 nënpar. 4 të KPK dhe neneve 326, 365, 366 të KPP i shqipton,

## **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, e nëse i akuzuari kyen veprë tjetër penale brenda kohës së verifikimit, atëherë dënimi me burgim me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg në të cilin do t'i llogaritet edhe koha a kaluar në paraburgim, si dhe

## **DËNIM PLOTËSUES**

**KONFISKOHEN** përherë: Një Revole e tipit "TT" 7,62 pa numër serik me një fatrollë por pa fishekë, të precizuara si në Vërtetimin mbi marrjen e përkohshme të sendeve 2011-AG/0058 të datës 15.01.2011, si mjet i kryerjes së veprës penale.

I akuzuari obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.204-2/2011 të datës 18.04.2011, ka akuzuar EN, për shkak të veprës penale Mbajtja, në pronësi, kontroll,posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.1 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti seancë të shqyrtimit gjyqësor me datë 30.04.2018, në të cilën i akuzuari E.N, duke qenë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimi të fajësisë, vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, deklaroi se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pasi që e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me faktet dhe provat që mbështet aktakuza andaj, mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilën do ta pranoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Pas pranimit të fajsisë dhe pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata duke vlerësuar se pranimi i fajsisë nga i akuzuari është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe të vullnetshme ka pranuar fajsinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimit të fajsisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, e aprovoi pranimin e fajsisë nga i akuzuari për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoi se meqenëse i akuzuari ka pranuar fajsinë dhe dyshimi i bazuar mire se i njëjti ka kryer këtë veprë penale se është kryes i kësaj vepre penale vërtetohet në seancën e shqyrtimit gjyqësor me pranimin e fajsisë nga i pandehuri andaj, propozojmë gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas KPK-SË. Ka propozuar se me rastin e matjes së dënimit ta këtë si rrethane lehtësuese pranimin e fajsisë nga i pandehuri dhe pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale.

I akuzuari E.N në fjalën përfundimtare theksoi se ndihet i penduar për veprën e kryer, dhe se deri më sot asnjëherë nuk ka kryer veprë tjetër penale. I njëjti premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprë tjetër penale dhe kërkoi nga gjykata një dënim më të butë meqenëse mban dy familje sepse baba i ka vdek andaj ka lutur gjykatën të këtë parasysh këtë rrethane.

Gjykata, pas aprovimit të pranimit të fajsisë së të akuzuarit, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve nga fjala e tyre përfundimtare si dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, andaj pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit si, rrethanat lehtësuese, pranimin e fajsisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pendimin për veprën e kryer, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit komfor dispozitave ligjore nga neni 44, 66 dhe 67 të KPK për zbutje të dënimit, i shqiptoi dënim të zbutur me burgim, të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhën e caktuar verifikuese, siç është e precizuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale të kësaj natyre dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK dhe në fund, me bindje se i akuzuari në të ardhmen nuk do të përsërisë veprë tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, gjykata e mori në bazë të nenit 60 të KPK lidhur me nenin 328 par.5 të KPK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.262/2011 me datë 30.04.2018**

**Zyrtare ligjore,  
Albulena Ademi**

---

**Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare,  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.